

VENDIM
Nr. 320, datë 28.5.2014

**PËR MIRATIMIN E NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE TË
REVIZIONUARA (REV.2)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12/2 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004, “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, dhe të pikës 7 të vendimit nr.426, datë 15.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e zbatimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (Rev.2), të miratuar paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2), e njohur shkurtimisht “NVE Rev.2”, zbatohet për mbledhjen, klasifikimin dhe publikimin e të dhënave statistikore zyrtare.
 3. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2) zbatohet nga agjencitë statistikore, ministrinë e linjës, institucionet qendrore dhe vendore, personat fizikë dhe juridikë, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
 4. Kodet statistikore të veprimtarive ekonomike, të përdorura deri para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zëvendësohen me kodet e parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (Rev.2), bashkëlidhur këtij vendimi.
 5. Instituti i Statistikave kryen përditësimin e informacionit statistikor zyrtar, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Ngarkohen institucionet dhe subjektet e përmendura në pikën 3 për marrjen e masave përgatitore për zbatimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (Rev.2), deri në datën 1.1.2015.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama